



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 502, datë 13.09.2024

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Emona Muçi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile, është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përket me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, në bazë të kategorisë së çështjes (*padi themeli ose kërkesë civile*), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar përgjithësisht “*Procedura*”, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës lidhur me plotësimin e parakushteve procedurale në drejtim të juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore (*elementë të cilët analizohen në çdo vendim*) evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesën e palës për shtimin, ndryshimin apo saktësimin e objektit të padisë,¹ (ii) shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, nisur nga natyra e konflikti, kundërshtim i veprimeve përmbartimore,² (iii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë, thirrjen në gjykim edhe të personave të tjetër të paditur,³ etj.

Pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar përgjithësisht “*Rrethanat e faktet*” duke i parashtruar ato në mënyrë të plotë, të qartë dhe duke integruar përmbajtjen e provave dhe analizën e tyre, së bashku me faktin, në varësi të volumit të rrethanave të faktit, sipas kërkesës objekt shqyrtimi. Në vendimet burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë të detajuar duke u shoqëruar në çdo rast me referimin, citimin e pjesshëm kur është rasti, si dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të saj lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes. Edhe në rastet kur provat, për shkak të volumit apo rëndësisë së tyre, janë cituar pjesërisht,⁴ citimin vjen në funksion të analizës së tyre dhe përcaktimit të fakteve, të cilat deduktohen si pasojë e analizës së provave.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet

¹Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022, nr.2659, datë 16.05.2022 dhe nr.1458, datë 23.03.2022

²Vendimi nr.108, datë 18.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴Vendimi nr.2659, datë 16.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 36, 41, 42, 43, 47, 48, 61, 388, 609 dhe 610 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor, zgjidhjen e kontratës së furnizimit, shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të marrëveshjes së barrës siguruese, kundërshtim veprimesh përmbartimore, vërtetim e faktit juridik, pavlefshmëri titulli ekzekutiv*);
- nenet 35, 71, 72, 73 të K.Pr.Civile lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe ekzistencën e shkaqeve të papajtueshmërisë ose përjashtimit të gjyqtarit;⁵
- nenet 253 dhe 254 të K.Pr.Civile lidhur me aktet zyrtare; nenin 126 të K.Pr.Civile lidhur me vendimet përfundimtare;⁶
- nenin 32, germa “a”, të K.Pr.Civile lidhur me interesin e ligjshëm dhe legjitimitetin për të kërkuar rivendosjen e së drejtës;⁷ nenin 224 të K.Pr.Civile lidhur me marrjen e provës me ekspert; nenin 309 të K.Pr.Civile lidhur me çmuarjen e provave të marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme;⁸
- nenin 12 të K.Pr.Civile lidhur me barrën e provës;⁹
- nenin 185 të K.Pr.Civile lidhur me disponibilitetin e paditësit për të shtuar, pakësuar apo ndryshuar objektin e padisë;

⁵Vendimi nr.1314, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁶Vendimi nr.2588, datë 12.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷Kjo dispozitë identifikohet edhe në vendimin nr.1444, datë 18.03.2022

⁸Vendimi nr.2659, datë 16.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹Vendimi nr.1458, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nenin 510/e të K.Pr.Civile lidhur me aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë; nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me afatin ligjor të ngritjes së padisë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv;¹⁰
- nenin 610 të K.Pr.Civile lidhur me afatin për kundërshtimin e veprimeve përmbare; nenin 264 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin e palës për paraqitjen e provës shkresore për të ndihmuar në gjykimin e çështjes; nenin 527 të K.Pr.Civile mbi ekzekutimin e detyrueshëm dhe vënien e sekuestros mbi kreditë e debitorit; nenin 529 të K.Pr.Civile mbi sendet që përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit; nenin 581 të K.Pr.Civile mbi marrjen e lajmërimit të sekuestrimit;¹¹
- nenin 106 të K.Pr.Civile, si dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me llogaritjen e shpenzimeve gjyqësore.¹²

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në vendimet gjyqësore objekt vlerësimi (*me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor, zgjidhjen e kontratës së furnizimit, shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të marrëveshjes së barrës siguruese, kundërshtim veprimesh përmbare, vërtetim e faktit juridik, pavlefshmëri titulli ekzekutiv*) gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme, kryesisht në lidhje me:

- *Padinë për shpërblimin e dëmit*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm; nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil në lidhje me shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor, nenet 625, 640, 641 të K.Pr.Civile, lidhur me shpërblimin e dëmit të pësuar (*dëmi pasuror në formën e humbjes së pësuar dhe fitimit të munguar, shpërblimin e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial*). Po ashtu, gjyqtarja identifikon dispozita të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar. Rregullore nr.53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, e ndryshuar.¹³

¹⁰Vendimi nr.3934, datë 15.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹¹Vendimi nr.108, datë 18.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹²Në të gjitha vendimet burim vlerësimi

¹³Vendimi nr.2659, datë 16.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- *Pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv të faturave*, ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (*nenin 609 të K.Pr.Civile*), në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv në funksion të analizës lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes. Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjit nr.8975, datë 21.11.2022 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv”, ndryshuar me ligjin nr. 9286, datë 30.09.2004; ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të UKT sh.a”, si ligj të zbatueshëm në lidhje me llogaritjen e vlerës së detyrimit.¹⁴
- *Shpërblimin e dëmit që buron nga zgjidhja e marrëdhënies së punës*, ku gjyqtarja identifikon si ligj të nenet 3, 6, 12, 129, 138, 140, 143, 144, 145, 147, 149, 153, 155 të K.Punës, lidhur me veprimin në hapësirë dhe kohë të Kodit të Punës, kuptimin e kontratës së punës, zbritjen nga paga, transferimin e ndërmarrjes, kohëzgjatjen e kontratës së punës, afatin e njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës, procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, shpërblimin për vjetërsi në punë, zgjidhjen e kontratës së punës në kohë të papërshtatshme, afatin në rastin e zgjidhjes së kontratës me afat të caktuar, shkaqet e justifikuara të zgjidhjes së kontratës, pasojat në rastin e zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës. Gjithashtu, gjyqtarja identifikon nenin 95, paragrafët 1, 2 dhe 6 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, lidhur me emërimin, shkarkimin, e administratorit të shoqërisë, nenin 220 të ligjit nr. 9901/2008 lidhur me çregjistrimin si pasojë ligjore në rastin e shoqërisë që përthithet.¹⁵
- *Pavlefshmërinë absolute të marrëveshjes së barrës siguroese*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm dispozitat të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese”, i ndryshuar lidhur me qëllimin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, natyrën juridike të kuotës, nartën e barrës siguroese, dispozitat ligjore lidhur me mënyrat e fitimit apo kalimit të kuotave dhe kushtëzimit të kalimit të tyre, dispozitat statutore lidhur me kushtet për transferimin e kuotës, si dhe dispozitat e marrëveshjes së barrës siguroese. Gjithashtu gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm neni 690 i K.Civil në lidhje me efektet e kontratës, neni 204 i K.Civil për respektimin e të drejtës së parablerjes midis bashkëpronarëve që kanë në bashkëpronësi një send të paluajjtshëm, nenin 92/a të K.Civil lidhur me veprimet juridike të pavlefshme që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.¹⁶
- *Padinë për zgjidhjen e kontratës së furnizimit dhe kthimin e shumës së subvencioneve*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 419, 420, 463, 451, 481, 659, 698, 476 dhe 772 të K.Civil mbi kuptimin dhe lindjen e detyrimeve; afatin e ekzekutimit të detyrimit, mënyrën e ekzekutimit

¹⁴Vendimi nr.3934, datë 15.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵Vendimi nr.1444, datë 18.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁶Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

të detyrimeve që lidhen me pagesën e një shume parash; vonesën e debitorit, përmbajtjen e kontratës, për zgjidhjen e kontratës, efektet e mosekzekutimit të detyrimeve dhe mbi kuptimin e kontratës së furnizimit.¹⁷

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Punës dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 116 të Kushtetutës në lidhje me përcaktimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në hierarkinë më të lartë se ligjet, nenet 117/3 dhe 122 të Kushtetutës lidhur me procedurat e ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare, si një akt normativë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe epërsinë që kanë këto marrëveshje të ratifikuara mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Dispozitat e Konventës mbi Transportin Rrugor Ndërkombëtare të Mallrave (CMR) e ratifikuar me ligjin nr.9503, datë 03.04.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR) dhe protokollin e nënshkrimit”, si dhe dispozitat Protokollit Shumëpalësh mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave, ratifikuar me ligjin nr. 9624, datë 16.10.2006, citon nenet 23, 24, 29 dhe 36 të Konventës lidhur me përgjegjësinë për humbjen e mallit, proceset gjyqësore lidhur me humbjen, dëmtimin apo vonesën kundër transportuesit;¹⁸
- nenin 42 të Kushtetutës, lidhur me të drejtën e çdo personi fizik apo juridik që pretendon se i është cenuar një e drejtë subjektive që t’i drejtohet gjykatës për të rivendosur të drejtën e tij.¹⁹
- nenin 44 të Kushtetutës lidhur me të drejtën e dëmshpërblimit për pushim nga puna.²⁰

Lidhur me konfliktin e normave, evidentohet të jetë analizuar në mënyrë të detajuar hierarkia e normave, ku gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm, atë të marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, si ligji me fuqinë më të lartë në piramidën e normave juridike, pas Kushtetutës (neni 116 i Kushtetutës). Duke ballafaquar normat konventore dhe ato të legjislacionit të brendshëm, gjyqtarja me të drejtë zgjedh të aplikojë normat e posaçme dhe më specifike (*lex specialis*), të cilat përkojnë gjithashtu me normat me fuqinë juridike më të lartë në piramidën e ligjit.

¹⁷Vendimi nr.1314, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁸Vendimi nr.1458, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹Vendimi nr.3934, datë 15.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁰Vendimi nr.1444, datë 18.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

KONKLUZIONI

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta për të identifikuar konfliktin e normave juridike, jo vetëm të një karakteri të brendshëm, por edhe kur ato janë norma të një niveli të ndryshëm hierarkie.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin

teleologjik të normës konkrete (*ratio legis-për të cilën ajo është krijuar*), por edhe sipas interpretimit literal e gramatikor, apo sistematik të normave, duke e përjasuar kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, në funksion të konkluzionit në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet burim vlerësimi përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- interpreton në mënyrë tekstuale, sistematike dhe teologjike normat konventore (nenet 23, 24, 29 dhe 36 të Konventës CMR) normat kushtetuese (nenet 116,122,145 të Kushtetuese) dhe norma kodifikuese (Kodi Civil), po ashtu edhe normat kontraktore, të dakordësuara nga palët në marrëveshjen e tyre;²¹
- interpreton nenet 608 dhe 609 të K.Civil në funksion të trajtimit të elementëve të padisë së kërkimit të dëmit jashtëkontraktor, duke përcaktuar kushtet për pasjen e dëmit jashtëkontraktor, e përkatësisht faktin e paligjshëm, dëmin e paligjshëm, lidhjen shkakësore dhe fajin, duke u ndalur në analizën e detajuar të lidhjes shkakësore;²²
- interpreton në mënyrë literale dhe sistematike nenin 68/2 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nenin 1 të ligjit nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese” në funksion të argumentimit se në rastin konkret barra siguroese si një e drejtë reale është vendosur mbi një pasuri të luajtshme të paprekshme, pasi kuat për nga natyra është një pasuri e luajtshme, e pa materializuar në një objekt fizik të prekshëm. Interpreton në mënyrë literale nenin 73 të ligjit nr.9901/2008 duke argumentuar se pikën 1 të këtij neni, ligjvënësi ka parashikuar si rregull të përgjithshëm lejimin e transferimit të kuotave të kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa në pikën 3 të tij, ligjvënësi ka sanksionuar një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, duke parashikuar që ortakët me vullnetin e tyre të lirë mund të vendosin rregulla në statut që kushtëzojnë kalimin e kuotave. Interpreton konceptin e barrës siguroese si një e drejtë reale mbi pasuri të paprekshme (*ku këtu bëhet fjalë për kuotën*) ose pasuri të luajtshme të prekshme, si të

²¹Vendimi nr.1458, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²²Vendimi nr.2659, datë 16.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

tashme, ashtu dhe të ardhme, që siguron një ose më shumë detyrime që kanë lindur përpara ose pas lidhjes së marrëveshjes siguroese. Trajton institutin e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, që janë ato të cilat nuk krijojnë asnjë pasojë juridike, ato veprime, që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, duke interpretuar nenin 92/a të K.Civil.²³

- interpreton në mënyrë literale dispozitën materiale nenin 144 të K.Punës lidhur procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi. Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike nenet 149, 143, 146, 147 dhe 153 të K.Punës lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, afatin e njoftimit, zgjidhjen e kontratës së punës në kohë të papërshtatshme, shkaqet e arsyeshme dhe shkaqet e pajustificuara në zgjidhjen e kontratës së punës; Gjithashtu interpreton nenet 145 dhe 92 të K.Punës me qëllim analizimin e pretendimeve të paditëses për përfitimin e shpërblimit për vjetërsi dhe pushimeve vjetore të papaguara.²⁴

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket aspekteve meritore, por edhe atyre procedurale në rastin kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- interpreton në mënyrë literal dhe teologjike neni 529/6 të K.Pr.Civile duke analizuar se qëllimi i ligjvënësit ka qenë mbrojtja e debitorit deri në një masë të arsyeshme, duke i lejuar atij të sigurojë jetesën minimale ndërmjet gëzimit të pensionit të pleqërisë. Nga ana tjetër e drejta e debitorit/pensionit duhet vënë në balancë me të drejtën e kreditorit për të realizuar kredinë e tij.²⁵
- interpreton titullin ekzekutiv si koncept juridik, konkretisht nenin 510, germa “e”, të K.Pr.Civile lidhur me aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë. Në këtë kuadër sqaron se, në nenin 510 germa “e” të K.Pr.Civile përcaktohet se janë tituj ekzekutiv aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre. Në rastin konkret, gjykata konstaton se fatura tatimore e ujit të pijshëm është titull ekzekutiv, pasi parashikohet si e tillë në bazë të ligjit nr.8975, datë 21.11.2002 “*Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv*”, ndryshuar me ligjin nr.9286, datë 30.09.2004. Trajton padinë e kundërshtimit të titullit ekzekutiv referuar nenit 609 të K.Pr.Civile, duke zhvilluar analizë të detajuar të kërkimeve të palës paditëse.²⁶

²³Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁴Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁵Vendimi nr.108, datë 18.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁶Vendimi nr.3934, datë 15.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- interpreton nenet 338 dhe 339 të K.Pr.Civile duke analizuar kriteret e domosdoshme ligjore për ushtrimin e kërkesës për vërtetimin gjyqësor të faktit. Interpretën dispozitën procedurale nenin 32 të K.Pr.Civile mbi interesin e ligjshëm për kërkimin e vërtetimit të faktit juridik., si dhe interpreton nenin 253 të K.Pr.Civile mbi fuqinë provuese të akteve zyrtare.²⁷

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, rezultojnë se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- referon vendimin nr.501, datë 09.10.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin e Kodit të Punës për kërkimet që lindin për shkak të marrëdhënies së punës së administratorit me shoqërinë tregtare. Vendimin nr.00-2013-665 (151), datë 26.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë lidhur me qëndrimin e mbajtur në këtë vendim për legjitimitetin pasiv të palës së paditur në gjykim që i takon pikërisht Shoqërisë dhe jo ortakut të kësaj shoqërie. Referon vendimin nr.260, datë 09.11.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr.00-2014-850 (184), datë 04.03.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë lidhur me pasojat ligjore në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat, pa shkaqe të justifikuara dhe në kohë të papërshtatshme. Në shqyrtimin e pretendimeve të palëve rezultojnë se gjyqtarja i është referuar vendimit unifikues nr.19, datë 15.11.2007 të Gjykatës së Lartë duke zbatuar dhe respektuar konkluzionet e arritura në këtë vendim unifikues. Interpretimi i koncepteve ligjore janë deduksion dhe rrjedhojë e respektimit të këtij vendimi.²⁸
- referon jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, konkretisht Vendimin Unifikues nr. 3 datë 29.03.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me shkakun ligjor të padisë.²⁹

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezultojnë kujdesi i përhershëm i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njëj, referon dhe zbaton parimet materiale e procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

²⁷Vendimi nr.1630, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸Vendimi nr.1444, datë 18.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁹Vendimi nr.5084, datë 07.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- parimin e procesit të rregullt ligjor në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, disponibilitetin e padisë nga pala paditëse në përcaktim ne objektit të mosmarrëveshjes, barrën e provës, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim.
- parimin e prezumimit të fajësisë në kuadër të përgjegjësisë nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor;³⁰
- parimi i së drejtës së dëmshpërblimit në rastet e pushimit të padrejtë nga puna referuar nenit 44 të Kushtetutës;³¹
- parimin e zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare;³²
- parimin e proporcionalitetit, për mbrojtjen e debitorit (përjashtimi i sekuestrimit të pasurisë) deri në një masë të arsyeshme,³³ etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuara, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të referuar, zbatuar dhe kur është rasti për të analizuar aspekte të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet brumi vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

³⁰Vendimi nr.2659, datë 16.05.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³¹Vendimi nr.1444, datë 18.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³²Vendimi nr.1458, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³³Vendimi nr.108, datë 18.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, nuk rezulton përdorimi i termave latine,³⁴ por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

³⁴ Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën apo cilësinë e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit dhe shpesh identifikohen me fjali tematike.

Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve dhe përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të drejtpërdrejtë, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, i bën në tërësi vendimet të kuptueshme, duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja në mënyrë të specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, në shumicën e vendimeve të analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve procedurale të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, jo vetëm prezantimit të fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat janë të listuar formalisht me tituj, si: (i) Procedura; (ii) Rrethanat e faktet; (iii) Pretendimet e palëve dhe (iv) Vlerësimi i Gjykatës:

- (i) Në pjesën e parë të titulluar përgjithësisht “*Procedura*”, sikurse rezulton nga titulli parashtrohen aspekte procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën, formimi i trupit gjykues apo edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. ndryshimi, shtimi apo pakësimin e objekti të padisë.
- (ii) Në pjesën e dytë të titulluar “*Rrethanat e faktet*” gjyqtarja përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit, siç ka rezultuar i provuar në gjykim.
- (iii) Në pjesën e tretë të titulluar “*Pretendimet e palëve*”, e cila është prezentë kryesisht në vendimet me natyrë më komplekse, gjyqtarja përshkruhen në mënyrë të përmbledhur dhe provat që secila prej tyre pretendon se i provon.
- (iv) Në pjesën e titulluar “*Vlerësimi i gjykatës*”, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja para arsyetimit ligjor, ka referuar dhe cituar në një nënndarje me vetë dispozitat e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të cilat më pas integrohen në arsyetim. Në ndonjë rast ligji i zbatueshëm, si ai me natyrë procedurale, ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij.³⁵ Në një prej vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja ka ndjekur metodën IRAC,³⁶ duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, pyetjet/çështjet ligjore të vlerësuara thelbësore,³⁷ për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe duke organizuar më pas analizën ligjore në drejtim të përgjigjes së këtyre pyetjeve.

³⁵Vendimet nr.2588, datë 12.05.2022 dhe nr.1314, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁶IRAC (*issue, rule, analysis, conclusion*) është akronim për termat çështja, rregullimi (ose ligji përkatës), analiza (ose arsyetimi) dhe konkluzioni (ose përfundimi), metodë e përdorur në hartimin e dokumenteve dhe raporteve të caktuara ligjore.

³⁷Vendimi nr.1444, datë 18.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), si edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashkrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese e cila mos pasqyrimin e pretendimeve të palëve e ka vlerësuar si cenim të të drejtës për akses në gjykatë dhe të drejtës për t'u dëgjuar, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata (*shkrimi i çështjeve për zgjidhje sipas metodës IRAC*) duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që pjesët përbërëse të cituara më sipër të jenë vendosur me titujt përkatës në pjesën arsyetuese të vendimit, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta për përmbajtjen e vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.³⁸

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Vendimet gjyqësore dominohen nga procesi analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkrues të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike. Jepen argumente për secilin kërkim objekt padie, duke u ndaluar në interpretimin e ligjit dhe mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak- pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura.

Në të gjitha vendimet e analizuar, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithmonë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin, pretendimin e ngritur, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe atë material. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

³⁸Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiouvs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq. 33

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Shpjegimet dhe prapësimet parashtrohen fillimisht në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit, ndërsa më pas merren në analizë më vetë, të ndërthurura me analizën e provave dhe zbatimin e ligjit. Pretendimet e palëve, marrin një përgjigje të argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Në këtë kontekst vlerësohet një shkallë shumë e lartë kujdesi e gjyqtares për identifikimin e marrëdhënies shkak-pasojë dhe zbatimin e dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Në tërësi në vendimet e vëzhguara gjyqtarja e shoqëron analizën e saj juridike me praktikën gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë duke marrë në analizë të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2022, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar në total 92 çështje,³⁹ për të cilat ligji parashikon afat ligjor, nga të cilat 83 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor.⁴⁰

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (*gjithsej 83 çështje*), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (*92 çështje*), **sipas një analize vetëm matematikore, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 90% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, zëvendëskryetari i gjykatës në mendimin e tij e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi si “*Shumë të lartë*”. Po kështu, edhe gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “*Shumë e lartë*”, duke parashtruar se është përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve, sipas kategorive, por gjithmonë duke u kujdesur që kjo të mos cenoje kontradiktoritetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të

³⁹Këtu nuk janë përfshirë çështjet me numër rendor 1, 53 dhe 56 (*numër akti 7, 1171 dhe 982*), në tabelën nr.6 pasi referuar shpjegimeve të dhëna nga gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit rezulton se këto çështje kanë si objekt depozitim aktesh të Sindikatave dhe nuk i nënshtrohen rregullave dhe afateve ligjore të përcaktuara në ligjin Për organizatat jofitimprurëse” por Kodit të Punës i cili nuk ka vendos afate ligjore për shqyrtimin e tyre dhe si të tilla do të konsiderohen çështje me standard gjykimi

⁴⁰Tabela nr.1-çështjet me numër rendor 65, 68, 87, 89, 92, 93, 96, 97, 98, 101, 107, 108, 109, 110, 113, 114, 118 dhe 119; Tabela nr.2-çështjet me numër rendor 2, 5, 60, 126, 138, 456-466; Tabela nr.6-çështjet me numër rendor 2-9, 11, 13-15, 20-52, 54, 55, 59 dhe 60.

gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor. Respektimi i afateve ligjore për vitin 2022 në disa raste ka qenë i pamundur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i gjyqtarës.

Gjithashtu, gjyqtarja ka parashtruar disa nga shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve me afat ligjor dhe konkretisht:

- i) Organika jo e plotë e gjyqtarëve (*nga 37 gjyqtarë që kishte seksioni civil e tregtar në vitin 2017, në vitin 2022 ky seksion kishte 17 gjyqtarë*) e bën të pamundur respektimin e të gjithave afateve procedurale të caktuara nga ligji për të përfunduar gjykimi i një çështje, pasi për shkak të ngarkesës për një çështje civile zhvillohen tre seanca në një vit kalendarik (*bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur pjesë nga analiza e gjykatës të vitit 2017 dhe vitit 2022*).
- ii) Rritja e ngarkesës së punës përgjatë viteve 2019-2022 për shkak të rishpërndarjes me short të dosjeve të gjyqtarëve të pezulluar ose të shkarkuar nga procedura e Vetting-ut (*bashkëngjitur formularit gjyqtarja ka paraqitur urdhrat e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të Gjykatës*).
- iii) Në rastin e kërkesave me objekt “Sigurim padie” ato janë vënë në lëvizje brenda 5-ditëve, por përfundimi i tyre përtej këtij afati ka ndodhur për shkaqe objektive dhe që lidhen me njoftimin e palëve ndërgjyqëse kur shqyrtimi i tyre është bërë në seancë, respektimin e parimit të kontradiktoritetit apo kërkesat për shtyrje të seancës nga palët ndërgjyqëse për arsye objektive.
- iv) Në rastin e kërkesave për regjistrimin e OJF në disa raste kërkesat janë lënë me të meta, duke njoftuar palën për plotësimin e tyre. Gjithashtu, kohë kërkon edhe administrimi i praktikës në Zyrën e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse, ku në disa raste kjo praktikë ndodhet në gjykatën e apelit, pasi mund të jetë ankimuar një vendim i mëparshëm.
- v) Në lidhje me shqyrtimin e ankimeve me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbareme” në disa raste ka qenë e nevojshme kryerja e seancës dëgjimore për të thirrur dhe dëgjuar palët ndërgjyqëse, apo në disa raste gjykata ka thirrur si person të interesuar në proces edhe kreditorin. Po kështu në ankimet kundër veprimit përmbareme të përcaktimit të vlerës së sendit, detyrimisht është zhvilluar seancë gjyqësore dëgjimore për të realizuar aktin e ekspertimit. Në disa raste ankimet kundër veprimeve përmbareme kanë qenë me të meta dhe u është lënë koha për të plotësuar të metat e ankimit. Gjithashtu, konstatohet se disa ankime kundër veprimeve përmbareme janë rishortuar nga gjyqtarë të tjerë dhe këtë të fundit nuk kanë mundur të gjykojnë brenda afatit ligjor 20 ditë këto ankime.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbareme” neni 610 i K.Pr.Civile parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e një afati të arsyeshëm për plotësimin e të metave, sipas parashikimeve të nenit 154/a të K.Pr.Civile;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbaruesit gjyqësor dhe lënien e një afati të arsyeshëm për të paraqitur aktet e dosjes përmbarimore (*nëse ato nuk janë paraqitur të plota nga ankuesi*) dhe për të parashtruar qëndrimin e tij lidhur me ankimin;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t'u dëgjuar.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces, si dhe për të mundësuar kryerjen e hetimit të plotë dhe gjithanshëm lidhur me çështjen, pa përllogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbaruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji. Nëse për gjykimin në shkallë të parë do të zbatohet i njëjti afat, pra afati 30 ditë për shqyrtimin në dhomë këshillimi dhe 45 ditë për shqyrtimin në seancë, rezulton se për 6 (gjashtë) çështjet afati i përfundimit të gjykimit nuk do të ishte tejkaluar pasi çështjet kanë përfunduar respektivisht për 23, 33, 31, 45, 44 dhe 27 ditë. ***Për këto arsye, këto gjashtë çështje përllogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.***

Në çështjet me objekt “*Ndihmë juridike dytësore*” apo “*Përrjashtim nga taksat gjyqësore*”, nga 13 çështje, rezultojnë se të çështja janë gjykuar jashtë afatit 5 ditor, të cilat kanë përfunduar për 57, 51, 92, 44, 10, 43, 73, 8, 18, 20, 6, 15 dhe 14 ditë. Ndërkohë që rezultojnë se çështjet me numër rendor 461 dhe 464, kanë përfunduar respektivisht për 8 dhe 6 ditë. Duke tejkaluar afatin ligjor me 3 dhe 1 ditë, tejkalime të cilat vlerësohen të jenë të papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përllogaritjen e afatit. ***Për këto arsye, këto dy çështje përllogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.***

Në çështjet me objekt “*Regjistrim*” apo “*Depozitim aktesh*”, nga 51 çështje, rezultojnë se 47 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit 15 ditor, të cilat kanë përfunduar respektivisht për 253, 60, 161, 32, 106, 21, 21, 17, 125, 104, 142, 18, 145, 154, 161, 123, 150, 95, 92, 188, 135, 136,

107, 56, 225, 177, 108, 82, 169, 104, 42, 187, 206, 198, 193, 133, 148, 119, 134, 43, 154, 94, 143, 92, 161, 93 dhe 73 ditë. Ndërkohë që evidentohet se çështjet me numër rendor 7, 8, 9 dhe 15, kanë përfunduar respektivisht për 21 ditë, 21 ditë, 17 ditë dhe 18 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor me 6 ditë, 2 ditë apo 3 ditë. Tejkalime këto që vlerësohen të pakonsiderueshme për vetë ngarkesën e punës dhe **si rrjedhim, këto katër çështje do të konsiderohen si të gjykuara brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligj.**

Sa më sipër, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës si më sipër, rezulton të jetë 71 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (71 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (92 çështje), gjyqtarja **rezulton që të ketë gjykuar 77% të çështjeve tej afatit ligjor.**

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 3 (tre) pikë. Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të ulët të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjes në periudhën e vlerësimit prej 2467 çështjesh, nga të cilat 1366 të mbartura nga viti 2021 dhe 1101 të regjistruara në vitin 2022, si dhe ka përfunduar 706 çështje. Ngarkesa e lartë parashtruar nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, si shkak për pamundësinë e respektimit të afateve të gjykimit është një e dhënë e cila mbështetet edhe nga të tabelat me të dhëna statistikore të administruara si burim vlerësimi.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka parashtruar se:

- *Përsa i përket kërkesave për sigurim padie* - Në Gjykatën e Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2022, ka pasur si praktikë punë që çështja e cila paraqitet nga pala në gjykatë, nuk shorthohej menjëherë në ditën që paraqitet padia së bashku me kërkesën për sigurimin e padisë, ankimi kundër veprimeve përmbartimore, apo kërkesa për sigurim padie, por shorthohej më vonë. Pas shortimit merrej në dorëzim nga gjyqtari në një ditë tjetër dhe më tej vijonte gjyqtari me veprimet e tij. Në mbështetje të këtij pretendimi gjyqtarja ka paraqitur printimet nga sistemi elektronik i gjykatës ku pasqyrohet tek çështjet me afate ligjore, data e regjistrimit, data e shortimit dhe data që ka ardhur dosja pranë trupit gjykues. Gjyqtarja ka paraqitur në mënyrë të detajuar të dhënat lidhur me datën e regjistrimit dhe shortimit të 6

çështje me objekt sigurim padie, në funksion të argumentimit se për të gjitha çështjet me objekt sigurim padie, që duhej të shqyrtoheshin brenda 5 ditëve sipas ligjit, konstatohet se janë marrë prej sekretares gjyqësore të gjyqtares mbi katër ditë pas regjistrimit të çështjes dhe në disa raste afati 5 ditor ka qenë i plotësuar. Gjyqtarja sqaron se kërkesat për sigurim padie gjithmonë prej saj janë vënë në lëvizje brenda afati 5 ditor të përcaktuar në K.Pr.Civile, por këto kërkesa nuk janë shqyrtuar për 5 ditë për shkaqe objektive të tilla si njoftimi i palëve ndërgjyqëse kur shtimi i tyre është bërë në seancë, respektimi i parimit të kontradiktoritetit, palët kanë kërkuar kohë të njihen me aktet, apo të paraqesin prova te tjera, etj. Në asnjë rast shqyrtimi i këtyre kërkesave mbi 5 ditë nuk kanë sjelle pasoja për palët ndërgjyqëse.

- *Përsa i përket çështjeve për regjistrimin e OJF apo depozitimin e akteve të OJF*, gjyqtarja argumenton se këto kërkesa janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor përsëri për shkaqe të pavarura nga veprimtaria e gjyqtarit, duke renditur si shkaqe: i) organikën jo të plotë të gjykatës për shkak të procesit të vettingut, ii) rishpërndarjen me short të dosjeve të gjyqtarëve të tjerë, iii) ngarkesën e punës. Gjithashtu, gjyqtarja parashtrohet se është jashtë kërkesave të arsyes që të vlerësohet se një gjyqtar me 2467 çështje në shqyrtim të respektojë afatet ligjore në lidhje me shqyrtimin e të gjithave kërkesave. Gjyqtari nuk ka kohë fizike pune për të menaxhuar një ngarkesë të tillë, për 237 ditë pune, duke vlerësuar se për këto 237 ditë pune gjyqtari ka detyrimin që të marrë pjesë në trajnim vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës. Këto kërkesa me një ngarkesë të tillë pune nuk mund të gjykoreshin brenda afatit ligjor, fakt ky që vërtetohet nga disa çështje të cilat i janë rishortuara këtij trupi gjykues, nga gjyqtarë të mëparshëm që i kanë pasur dhe këta të fundit nuk kanë mundur që t'i gjykojnë brenda afatit ligjor për shkak të ngarkesës. Në disa raste kërkesat janë lënë me të meta për plotësimin e akteve dhe janë njoftuar palët nëpërmjet shërbimit telefonik dhe gjykata është shprehur pasi kanë plotësuar të metat palët. Në disa raste shqyrtimi i kërkesës për depozitim është zgatur, pasi praktika e regjistrimit nuk ndodhej në Zyrën e Regjistrimit, por në Gjykatën e Apelit pasi ishte ankimuar një vendim i mëparshëm, apo pranë një gjyqtari tjetër dhe është pritur paraqitja e praktikës, pasi kërkesa nuk mund të shqyrtohet pa aktet.
- *Për sa i përket shqyrtimit të ankimeve me objekt kundërshtimi veprimeve përmbareme* - gjyqtarja parashtrohet se përveç ngarkesës së lartë, në shumicën e rasteve ka qenë e pamundur të respektohej afati 20 ditor, për arsye se: i) në disa raste ka qenë e nevojshme kryerja e seancës dëgjimore për të thirrur dhe dëgjuar palët ndërgjyqëse; ii) në disa raste është thirrur si person i interesuar në proces edhe kreditori, pasi kundërshtimi i veprimeve përmbareme kishte të bënte me llogaritjen e detyrimit nga përmbaremi dhe pjesëmarrja e kreditorit ishte e domosdoshme në proces; iii) në ankimet kundër veprimeve përmbareme të përcaktimit të vlerës së sendit, detyrimisht është zhvilluar seancë gjyqësore dëgjimore për të realizuar aktin e ekspertimit në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe vlerësimit të sendit, për të verifikuar pretendimet e palës ankuese; iv) në disa raste ankimet kundër veprimeve përmbareme kanë qenë me të meta dhe nga gjykata i është lënë afat ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, apo përfaqësuesit të rregullojë aktin e përfaqësimit; v) në disa raste ankime kundër

veprimeve të përmbardimore janë rishortuar nga gjyqtarë të tjerë, këta të fundit nuk kanë mundur të gjykojnë brenda afatit ligjor 20 ditë këto ankime.

- *Përsa i përket kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifa gjyqësore* - gjyqtarja parashtron se këto kërkesa janë shqyrtuar prej saj me përparësi pavarësisht ngarkesës së lartë, por për shkaqe të pavarura nga gjyqtarët të tilla si: i) caktimi i seancës gjyqësore për verifikimin e kushteve; ii) dhënies mundësi të kërkuarit të plotësojë dokumentacionin në përputhje me ligjin “Për ndihmën juridike falas”, nuk janë shqyrtuar brenda afatit 5 ditor.

Në përfundim, lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka kërkuar të vlerësohet me 15 pikë, pasi të dhënat statistikore në lidhje me respektimin e afateve ligjore, duhet të vlerësohen në raport me volumin e çështjeve shumë të lartë për një periudhë kohore nga viti 2019 deri në momentin e vlerësimit, si dhe respektimin e procedurave ligjore dhe parimeve të së drejtës procedurale civile në shqyrtimin e këtyre çështjeve si kontradiktoritet, parimi i barazisë së armëve etj.

KONKLuzioni

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore.

Për pikëzimin në rastin konkret duke pasur në konsideratë:

- i) ngarkesën e lartë të gjyqtarës;
- ii) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve; faktin se në disa raste shkak për mosrespektimin e afateve ligjore është bërë shortimi dhe kalimi i çështjes me vonese tek gjyqtarja, gjë që nuk është përgjegjësi e gjyqtarës;
- iii) numrin jo të lartë të çështjeve me afat ligjor, 92 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 13% të çështjeve të shqyrtuara prej saj në periudhën e vlerësimit;
- iv) rritjen e papritur të volumit të punës në muajt prill, korrik dhe tetor 2022 për shkak të rishortimeve si efekti i procesit të vettingut;

për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet tre nivele më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pavarësisht se përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton 77%. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit, objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Pavarësisht rrethanave konkrete që lidhen me kushtet e punës, numri relativisht i vogël i çështjeve me afat gjykimi, nuk justifikon një pikëzim maksimal, pasi gjyqtarja duhej të kishte treguar një shkallë më të lartë kujdesi në shqyrtimin me përparësi të këtyre çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor, si dhe shkaqeve që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2022, duke iu referuar standardit minimal për çdo kategori çështjes, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, rezulton se nga 614 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 536 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë 87% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, zëvendëskryetari i gjykatës në mendimin e tij e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi si “*Shumë të lartë*”. Po kështu, edhe gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “*Shumë e lartë*”, duke parashtruar se tejkalimi i afateve orientuese, nuk ka ndodhur për shkaqe të sjelljes së saj apo neglizhencës, por për arsye objektive, forcë madhore, procedurës së Vetting-ut, organikës jo të plotë në seksionin civil dhe tregtar, rishpërndarjen e dosjeve të gjyqtarëve të tjerë, kompleksiteti i çështjeve, apo përfshirja në llogaritje të kohëzgjatjes së gjykimit edhe të muajt gusht, në të cilin nuk zhvillohen seanca gjyqësore për shkak të pushimeve vjetore.

Gjithashtu, gjyqtarja parashtron se në llogaritjen e afatit nuk duhen përllogaritur afatet e kaluara sipas nenit 399/2, pika 3 të K.Pr.Civile, i) në lidhje me kohën kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, ii) është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese dhe iii) kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim. Po kështu, duhet të mbahet parasysh fakti që ndryshimi i Kodit të Procedurës Civile në lidhje me komunikimin e kërkesëpadisë dhe akteve, afati i përcaktuar nga ligji në lidhje me paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes për 30 ditë, komunikime të cilat për shkak të largimit të palëve apo adresave të pasakta domosdoshmërisht duhen të përsëriten apo të njoftohen me shpallje, për një proces të rregullt ligjor. Një tjetër shkak i parashtruar nga gjyqtarja është edhe ndikimi infeksioni Covid-19

në kohëzgjatjen e afateve të gjykimit, pasi pezullimi i veprimtarisë gjyqësore shkaktojë rritjen e numrit të çështjeve të pashqyrtuara. Gjithashtu, bojkoti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë gjatë muajt qershor 2022 ka sjellë zgjatje të afatit të gjykimit në disa çështje.

Në lidhje me shqyrtimin e urdhrave të ekzekutimit gjyqtarja parashtron se, për vitin 2022 ka shqyrtuar vetëm kërkesat me objekt lëshim urdhër ekzekutimi që nuk kërkonin aplikimin e nenit 511 tek kreditë konsumatorë të dhëna nga Bankat dhe Institucionet Financiare, në kushtet kur me vendim të ndërmjetëm ka dërguar për kontroll të kushtetutshmërisë të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të K.Pr.Civile (*bashkëlidhur formularit gjyqtarja ka paraqitur vendimin e ndërmjetëm nr.7149/433 akti, datë 23.02.2022 “Për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese”, si dhe shkresën nr.345/36 prot., datë 30.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore për 536 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja në muajin gusht (35 ditë). Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për kategorinë “Civile me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështja me numër rendor 79 (*1 çështje*) i është caktuar gjyqtares me short në datën 17.06.2021 dhe ka përfunduar në datën 18.01.2022 (215 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë) kjo çështje do të kishte përfunduar për 180 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 106 (*1 çështje*) i është caktuar gjyqtares me short në datën 26.04.2022 dhe ka përfunduar në datën 26.10.2022 (183 ditë). Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë) kjo çështje do të kishte përfunduar për 148 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 88 (*1 çështje*) ka përfunduar për 183 ditë, duke tejkaluar me vetëm 3 ditë afatin standard prej 6 muaj ose 180 ditë, ku këtu ka ndikuar edhe periudha e fund vitit që përkon me procesin e mbajtjeve të dosjeve nga administratat gjyqësore;

Për kategorinë “Civile pa palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 423, 445, 446 dhe 448 (*4 çështje*) i janë caktuar gjyqtares me short në muajit qershor apo korrik dhe kanë përfunduar në muajin shtator apo tetor, përkatësisht për 62, 80, 79 dhe 101 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin

përfunduar brenda standardit minimal kohor 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare, ose duke e tejkaluar atë me vetëm 6 ditë. Në këtë kategori çështjesh rezultojnë edhe çështjet me numër rendor 63, 374, 381 dhe 440 (4 çështje) të cilat kanë përfunduar respektivisht për 61, 69, 66 dhe 67 ditë, duke tejkaluar me vetëm 1, 9, 6 apo 7 ditë afatin standard prej 2 muaj ose 60 ditë;

- çështja me numër rendor 50, është regjistruar në datën 07.06.2021 dhe ka përfunduar në datën 13.12.2022, duke përfunduar për 554 ditë. Në aktet e paraqitura nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit rezulton se me vendimin e ndërmjetëm datë 23.02.2022 është vendosur pezullimi i gjyimit dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese me qëllim ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të K.Pr.Civile. Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë kërkesë ka disponuar me vendimin nr.30, datë 02.11.2022, shpallur në datën 30.11.2022, duke dërguar dosjen gjyqësore në gjykatë në datën 12.12.2022. Duke zbritur kohën e pezullimit (292 ditë), çështja do të kishte përfunduar për 262 ditë, pra tej standardit minimal kohor për shqyrtimin e kërkesave civile pa palë kundërshtarë, duke e tejkaluar atë me 202 ditë.

Për kategorinë “Tregtare me palë kundërshtare”, rezulton se:

- çështjet me numër rendor 2 dhe 25 (2 çështje) i janë caktuar gjyqtarës me short në muajin maji dhe kanë përfunduar në muajin nëntor, duke përfunduar për 185 ditë. Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2022 (35 ditë) këto çështje do të kishin përfunduar për 150 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve tregtare me palë kundërshtare;
- çështjet me numër rendor 32 dhe 34 (2 çështje) kanë përfunduar respektivisht për 186 dhe 183 ditë, duke tejkaluar me 6 dhe 3 ditë afatin standard prej 6 muaj ose 180 ditë, ku këtu ka ndikuar edhe periudha e fund vitit që përkon me procesin e mbajtjeve të dosjeve nga administratat gjyqësore, pasi në të dyja rastet çështjet i janë caktuar gjyqtarës në muajin dhjetor;

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 15 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkaluar me vetëm 1 deri në 9 ditë (i papërfillshëm). Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 614 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 521 prej tyre ose rreth **84.8% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 1 pikë.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- a) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 84.8%;

- b) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
 - c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit viti 2022, ku rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 706 çështje, nga të cilat 172 çështje me palë kundërshtarë ose 43% më tepër se standardi minimal sasior i punës;⁴¹
 - d) ngarkesa e lartë e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit dhe numri i lartë i çështjeve të mbartura (1366 çështje) të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve dhe për pasojë në pamundësinë e respektimit të standardeve orientuese për përfundimin e gjykimit të çështjeve;
 - e) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të dosjeve nga gjyqtarë të tjerë;
 - f) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore;
- pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për kategori, rezulton si më poshtë:

- (i) Për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, koha mesatare rezulton të jetë 401 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.

⁴¹Për aspektin sasior, sipas pikës 3, germa “e” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtarë.

- (ii) Për kategorinë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 244 ditë,⁴² pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- (iii) Për kategorinë “Tregtare me palë kundërshtare”,⁴³ koha mesatare rezulton të jetë 357 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- (iv) Për kategorinë “Tregtare pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 232 ditë,⁴⁴ pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- (v) Për kategorinë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare rezulton të jetë 501 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.

Duke u bazuar vetëm në analizën matematikore të të dhënave, rezulton se për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi minimal kohor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e saj “Shumë të lartë (më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të kategoritë e çështjeve)”, duke parashtruar se për çështjet e kategorisë tregtare me palë kundërshtare dhe civile me palë kundërshtare, i ka kushtuar rëndësi të veçantë fazës së veprimeve paraprake, duke marrë të gjitha masat nëpërmjet urdhrave apo vendimeve të ndryshme, të cilat e bëjnë efektive zhvillimin e seancës përgatitore (si njoftimi paraprakisht i ekspertit për seancën e parë përgatitore, njoftimi i palëve të treta për të cilët ka kërkesa për të qenë pjesë e procesit etj.). Në çështjet për të cilat, është urdhëruar kryerja e aktit të ekspertimit, gjithmonë merren masa që akti i ekspertimit të depozitohet paraprakisht nga eksperti, përpara seancës, me qëllim që palët të jenë të njohura me aktin e ekspertimit dhe të mos zhvillohen seanca jo efektive.

⁴²Në çështjen me numër rendor 1- koha e përfundimit të gjykimit është 271 ditë (23.07.2021-20.04.2022), duke e llogaritur këtë nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtares, referuar kjo nga të dhënat që gjyqtarja paraqiti në formularin e vetëvlerësimit. Po kështu, në çështjen me numër rendor 50- koha e përfundimit të gjykimit është 262 ditë, duke zbritur në këtë kohëzgjatje kohën e pezullimit të gjykimit prej 292 ditë.

⁴³ Në çështjen me numër rendor 19- koha e përfundimit të gjykimit është 362 ditë (18.03.2021-15.03.2022), duke e llogaritur këtë nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtares, referuar kjo nga të dhënat e dosjes së përzgjedhur me short me vendimin nr.1314, datë 15.03.2022.

⁴⁴Në çështjen me numër rendor 1- koha e përfundimit të gjykimit është 238 ditë (18.03.2021-11.11.2022), duke e llogaritur këtë nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtares, referuar kjo nga të dhënat që gjyqtarja paraqiti në formularin e vetëvlerësimit.

Gjyqtarja gjithashtu parashtron se çështjet civile dhe tregtare kanë qenë komplekse, ka pasur çështje për të cilat është paraqitur kërkesa për ndërhyrje kryesore, kundërpadi, padi që janë bashkuar në një çështje të vetme. Sipas Kodit të Procedurës Civile, rezulton se zbatohen të njëjtat rregulla si kërkesë padia edhe për padinë e ndërhyrësit kryesor, si dhe kundërpadinë. Për rrjedhojë është vijuar me të drejtën për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes pala kundër të cilës është drejtuar kundërpadia apo padia e ndërhyrësit kryesor. Rrjedhimisht kjo procedurë kërkon kohë. Në këtë rast gjyqtarja i është referuar vendimit të GJEDNJ, në çështjen *Manieri kundër Italisë* (Nr. 12053/86) ku është shprehur se *“Ndërhyrja në gjykimin civil të personave të tjerë, sollti tejzgjatje të afateve të procedimit. Nëse procesi gjyqësor do të kishte vazhduar vetëm mes personave të paraqitur në fillim si palë në çështje, gjykimi do të kishte ecur më shpejt dhe vendimi përfundimtar do të ishte marrë në një kohë më të afërt. Përfshirja e dy personave të tjerë gjatë ecurisë së procesit, sjell pretendime të reja, nevojën për kohë që të shqyrtohen këto kërkesa, vendime mbi to dhe si pasojë numër më të madh seancash gjyqësore.”*

Po kështu, gjyqtarja analizon faktet që kanë ndikuar në mos përfundimin e dy çështjeve me objekt “Çeljen e procedurave të falimentimit” brenda standardit minimal kohor, duke parashtruar si shkaqe: njoftimi i të gjithë kreditorëve të debitorit, kryerja e një akti ekspertimi për të përcaktuar nëse ka pasuri për të përballuar procedurat e falimentimit, të diktuar këto nga ligji “Për falimentin”. Gjyqtarja shprehet se pavarësisht e gjykimi nuk ka përfunduar brenda afatit orientues, ato janë përfunduar brenda një afati të arsyeshëm, marrë në konsideratë dhe ngarkesën e gjyqtarit, pasi dhe palët ndërgjyqëse në këto procese nuk kanë ushtruar ankim ndaj këtyre vendimeve duke qenë dakord me vendimmarrjen e gjykatës, duke konsideruar se të gjitha veprimet procedurale që janë kryer në kuadër të këtyre proceseve kanë qenë veprime të detyrueshme për t’u kryer në bazë të ligjit dhe ajo ka vepruar pa vonesa.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit zëvendëskryetari i gjykatës e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të këtij treguesi në nivelin *“Shumë të lartë”*.

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe sipas Metodologjisë së Pikëzimit ky tregues pikëzohet me 1 pikë. Bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, si dhe duke vlerësuar ngarkesën e gjyqtares, për këtë tregues gjyqtarja, pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (706 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (1101 çështje), rezulton 64%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit zëvendëskryetari i gjykatës dhe gjyqtarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin maksimal, duke parashtruar se një nga faktorët që ka ndikuar në mos shqyrtimin e kërkesave me objekt lëshim urdhër ekzekutimi përveç faktorit të mbingarkesës ka ndikuar dhe dërgimi në Gjykatë Kushtetuese, i kërkesës me qëllim kontrollin përfundimtar të kushtetutshmërisë të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të K.Pr.Civile. Gjyqtarja ka theksuar se numri i çështjeve të përfunduara përfaqëson një numër të konsiderueshëm çështjesh të përfunduara për një vit kalendarik, referuar ngarkesës së punës së gjyqtarit të miratuar, duke treguar një eficiencë të lartë të punës së gjyqtarit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo treguesin sasior të punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtë vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 120 çështje me palë kundërshtare.

Lidhur me rritjen e papritur të volumit të çështjeve evidentohet se gjatë vitit 2022, janë larguar nga detyra katër gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarës subjekt

vlerësimi me përfaqësues 240 çështje,⁴⁵ ku 120 prej tyre janë caktuar gjyqtarëve në datat 28 dhe 29 prill 2022,⁴⁶ çka ka rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e punës së gjyqtarëve, pa përfshirë këtu çështje të caktuara me shpejtësi.

Ndërkohë lidhur me treguesin sasior të punës së gjyqtarëve, rezulton se, gjatë vitit 2022 ka përfunduar në total 706 çështje si raportues, nga të cilat rreth 172 çështje themeli, duke tejkaluar në këtë mënyrë standardin minimal të ngarkesës me 52 çështje, si dhe ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtarë (534 çështje).

KONKLuzioni

Sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarëve të cilat lidhen me rritjen e papritur të numrit të çështjeve për shkak të pakësimit të numrit të gjyqtarëve (rindarja e çështjeve), ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit, mos shqyrtimin e kërkesave me objekt lëshim urdhër ekzekutimi për shkak të dërgimit në Gjykatë Kushtetuese, me qëllim kontrollin përfundimtar të kushtetutshmërisë të shkronjës “d” të paragrafit të pestë të nenit 511 të K.Pr.Civile, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi nga ajo që rezulton nga analiza matematikore, pasi nga kjo e fundit, duket që rendimenti si tregues i aftësive organizative të gjyqtarëve, është kushtëzuar në këtë rast nga fluksi i madh i prurjeve të çështjeve të reja, çka nuk është përgjegjësi e gjyqtarëve dhe jo nga mungesa e produktivitetit në menaxhimin e kohës, planifikimin e organizimit e procesit gjyqësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

⁴⁵Referuar informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, nëpërmjet postës elektronike datë 02.07.2024

⁴⁶Urdhret me nr.94, datë 28.04.2022 dhe nr.95, datë 29.04.2022 për rishortimin e çështjeve të gjyqtarëve F.Osmari dhe A.Capo

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar nga K.Pr.Civile, është si më poshtë:

- (i) Në çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 47 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (ii) Në çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (iii) Në çështjet e kategorisë “Tregtare me palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 54 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (iv) Në çështjet e kategorisë “Tregtare pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsyetimit është 20 ditë, pra e barabartë me afatin procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (v) Në çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune” koha mesatare e arsyetimit është 111 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se “Për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve për shqyrtim (krijuar si rezultat i procesit Vetting, pezullimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve), është e pamundur që të respektohen në të gjitha çështjet afatet ligjore në dorëzimin e dosjeve. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile, ka çështje civile me palë kundërshtare, të cilat janë komplekse, ku brenda një çështje është për shqyrtim padia, kundërpadia, apo ndërhyrja kryesore dhe rrjedhimisht arsyetimi i vendimit kërkon një kohë relativisht më të gjatë. Po kështu ka patur çështje të cilat duhej të interpretohej dhe zbatohej Konventa të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, apo çështje të cilat kërkojnë interpretime dhe sqarime të instituteve të së drejtës civile. Në punën time si gjyqtare, në momentin që jam vënë përballë faktit të ngarkesës së lartë në punë, jam përpjekur që në arsyetimin e vendimeve t`i jap përparësi çështjeve të cilat sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, duhet të arsyetohen brenda afatit të arsyeshëm si vërtetimeve të fakteve për marrëdhëniet e punës (që kanë të bëjnë me përfitimin e së drejtës së pensionit) etj. Vlerësoj se kam një aftësi shumë të lartë të arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore.... Theksoj se arsyetimi i vendimit është një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, pasi gjyqtari siç u sqarua dhe më sipër në këtë vlerësim në rubrikat e tjera duhet të bëjë një vendim të kuptueshëm, të qartë, që të përmbajë të gjithë elementët e vendimit sipas nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, të analizojë saktë provat, ligjin dhe institutet e së drejtës civile. Rrjedhimisht arsyetimi i një vendimi të tillë

në të drejtën civile kërkon kohën e mjaftueshme për t'u arsyetuar nga gjyqtari. Vlerësoj se një gjyqtar i ndodhur në këto kushte do i jap përparësi të drejtës për të arsyetuar një vendim sipas nenit 142 të Kushtetutës, duke u munduar që t'a arsyetojë sa më shpejt që të jetë e mundur brenda arsyes dhe ngarkesës që ka gjyqtari. Nga sa më sipër vlerësoj se raporti që del nga tabelat në lidhje me mesataren e ditëve të arsyetimit të vendimeve nuk mund të merret matematikisht, pasi për vitin 2022 që është objekt vlerësimi i përshpejtuar ka patur ngjarje dhe rrethana të ndodhura që nuk varen nga vullneti i gjyqtarit, ngjarje këto që e kanë vënë gjyqtarin në një ngarkesë pune tej kërkesave të arsyes. Prandaj në llogaritjen e dorëzimit të dosjeve duhen zbritur çështjet të cilat janë arsyetuar jashtë afatit, por që nuk janë ushtruar ankim nga palët. Po kështu ky afat duhet të shikohet në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara për vitin 2022 për këtë trup gjykues, si dhe duke marrë në konsideratë arsyet objektive të parashtruara më sipër gjerësisht”.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke kërkuar pikëzimin maksimal me 15 pikë, pasi për vitin 2022 ka patur ngjarje dhe rrethana të ndodhura që nuk varen nga vullneti i gjyqtarit, ngjarje këto që e kanë vënë gjyqtarin në një ngarkesë pune tej kërkesave të arsyes. Gjithashtu gjyqtarja parashtron se për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve për shqyrtim është e pamundur që të respektohen në të gjitha çështjet afatet ligjore në dorëzimin e dosjeve. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Civile ka çështje civile me palë kundërshtare, të cilat janë komplekse, ku brenda një çështje është për shqyrtim padia, kundërpadia, apo ndërhyrja kryesore dhe rrjedhimisht arsyetimi i vendimit kërkon një kohë relativisht më të gjatë.

Gjyqtarja parashtron se ndodhur në këtë situatë është përpjekur që të krijojë një balancë të barabartë në raport me ngarkesën që ka pasur për vitin 2022, në lidhje me vënien në lëvizje të dosjeve të marra në short, arsyetimin e vendimeve, si dhe kohës për zhvillimin e seancave përgatitore dhe gjyqësore. Arsyetimi i vendimit është një elemente shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, pasi gjyqtari duhet të bëjë një vendim të kuptueshëm, të qartë që të përmbajë të gjithë elementët e vendimit sipas nenit 310 të K.Pr.Civile, të analizojë saktë provat ligjin dhe institutet e së drejtës civile. Rrjedhimisht arsyetimi i një vendimit të tillë në të drejtën civile kërkon kohën e mjaftueshme për t'u arsyetuar nga gjyqtarit. Një faktor tjetër që ka ndikuar në punën e gjyqtarës, ka qenë edhe një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku gjyqtarja ka qenë në cilësinë e palës paditëse. Gjyqtarja argumenton se hapja e këtij procesi, normalisht ka kërkuar kohë që tek përpilimi i kërkesës padisë, parashtrimi i kundërshtimeve të deklaratës së mbrojtjes dhe pjesëmarrja personalisht në procesin civil.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar në koeficient jo më shumë se 20%.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pavarësisht se rezulton më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve dhe përkon me 9 pikë sipas Metodologjisë, pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi dhe konkretisht me 12 pikë, duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues, kompleksiteti i çështjeve, si dhe volumin e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 12 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi të dhënat e pasqyruara nuk përmbajnë vetëm numrin e seancave gjyqësore, por numrin e përbashkët të tyre me seancat përgatitore.⁴⁷ Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe*

⁴⁷Konkretisht evidentohet se në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 33, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 13 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 3934 vendimi, datë 15.07.2022, rezulton se janë zhvilluar 5 seanca përgatitore dhe 8 seanca gjyqësore. Po kështu, në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 59, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 6 seancë, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 5084 vendimi, datë 07.10.2022, rezulton se janë zhvilluar 3 seanca përgatitore dhe 3 seanca gjyqësore. Në tabelën nr. 1, çështja me numër rendor 12, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 15 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 2659 vendimi, datë 16.05.2022, rezulton se janë zhvilluar 8 seanca përgatitore dhe 7 seanca

profesional kur statistikat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Në mungesë të kësaj të dhëne, referimi do të bëhet ndaj 5 (pesë)⁴⁸ nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” dhe “Tregtare me palë kundërshtare”. Rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për kategorinë “Civile me palë kundërshtare” është 5 seanca dhe për kategorinë “Tregtare me palë kundërshtare” është 2 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë është **4.4 seanca gjyqësore**.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se nga ana e saj si gjyqtare janë marrë maksimalisht masat që seancat gjyqësore që zhvillohen të jenë produktive, duke kryer veprimet e nevojshme procedurale dhe si rrjedhojë ka kërkuar të vlerësohet maksimalisht për këtë tregues.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *për njoftimin e dëshmitarëve apo shoqërimin e detyrueshëm të tyre; dhënien kohë palës paditëse për t’u njohur me aktin e ekspertimit; për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me*

gjyqësore. Në tabelën nr. 5, çështja me numër rendor 19, ka të pasqyruar në kolonën e seancave gjyqësore 4 seanca, ndërkohë nga analiza e dosjes gjyqësore, me nr. 1314 vendimi, datë 15.03.2022, rezulton se janë zhvilluar 2 seanca përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore.

⁴⁸Duke përfshirë çështjen me nr.7424 regjistri, datë regjistrimi 20.09.2021, për shkak se i përket kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare

shkrim nga palët; për të shpallur gjykata vendimin përfundimtar. Rezulton se vetëm në një rast shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore është bërë mungesa e gjyqtares, por për shkaqe të justifikuara (për arsye shëndetësore).

Ndërkohë, konstatohet se seancat gjyqësore përgjithësisht janë shtyrë në një kohë të gjatë nga njëra tjetra, që varion nga 68 ditë deri në 122 ditë, por këtu përveç ngarkesë së madhe të punës në disa raste, shkak është bërë edhe leja vjetore në muajin gusht, apo periudha e fund vitit, që përkon me procedurën e mbartjes së dosjeve nga administrata.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtares së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.4 seanca por nga ana tjetër gjyqtarja ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, prandaj gjyqtarja lidhur me këtë tregues vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas

kategorive të çështjeve. Konkretisht, gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore (*neni 158/b i K.Pr.Civile*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, legjitimitimin e përfaqësuesve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të cilat variojnë maksimalisht deri në 15 minuta (*vonesa të papërfillshme*) të cilat lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse. Vetëm në dy raste, seancat rezultojnë të kenë filluar me vonesë mbi 15 minuta nga orari i planifikuar, por që nuk rezultojnë të kenë ardhur pasoja për zhvillimin e gjykimit.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (kërkesëpatria, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare).

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtarës të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, etika e gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD 2 (dy) ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr. 253/4 datë 22.09.2022 dhe nr. 2194/1 datë 05.07.2023, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Sa i përket masave disiplinore të dhëna rezulton se nuk është dhënë asnjë masë disiplinore për gjyqtaren {...} për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë në KLGJ me shkresën nr. 102/23 prot., datë 14.06.2024, lidhur me deklarin e pasurisë, konkludohet se: *“Deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarin të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.*

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indice që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares

Sipas tabelës përmbledhëse me të dhënat statistikore për sasinë, shpejtësinë, përjashtimet dhe heqjet dorë nga gjykimi, për vitin 2022, të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se për gjyqtaren {...}, ka pasur 4 kërkesa për përjashtim, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Gjithashtu, sipas të dhënave statistikore rezulton se subjekti i vlerësimit ka hequr dorë në 18 çështje, nga të cilat 13 kërkesa janë pranuar dhe 5 kërkesa janë rrëzuar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim (nga të cilat asnjë nuk është pranuar), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër për efekt të Metodologjisë së Vlerësimit është “I pakonsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilat pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës lidhur me këtë tregues e kanë vlerësuar aftësinë e saj në nivel “Shumë të lartë”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësi në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indice për cenim të konfidencialitetit apo të dhënat personale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se gjyqtarja është treguar shumë e angazhuar për ngritjen dhe diskutimin mbi çështje të caktuara juridike, duke ndarë me kolegët përvojën e përfituar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtarja ka është treguar komunikuese dhe bashkëpunuese me administratën gjyqësore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitete trajnuese të zhvilluara në 1 (një) ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në 2 (dy) ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit, lehtësuesit ose moderatorit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës, 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë si moderator me 1.5 si pjesëmarrëse. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës njëvjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 4 ditë trajnimi.

Referuar akteve të depozituara nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit, si dhe nga informacioni shtesë i dërguar nga Shkolla e Magjistraturës nëpërmjet postës elektronike në datën 28.05.2024, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime e organizuar nga Qendra e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin në Holandë (SSR), në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në datat 15-17 qershor 2022, vizitë studimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave për sa i takon formimit fillestar-mentoritmit të studentëve të Shkollës së Magjistraturës, në Utrecht, Holandë.

KONKLUZIONI

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 4 aktivitete trajnuese të shtrira në 7 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara në Ligjin për Statusin.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh.M është 7 ditë në vit (brenda kufijve ligjore 5-40 ditë në vit), duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues si më poshtë vijon:

Referuar dosjes personale të gjyqtarës subjekt vlerësimi rezulton se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.315, datë 22.07.2021 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024”, të përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 gjyqtarja {...} është miratuar si gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2021-2024. Me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 252, datë 07.07.2022 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023”, të ndryshuar, janë caktuar pranë gjyqtarës {...} për mentorim kandidatët për magjistratë z.Albert Keraj (*nëntor 2021- shkurt 2022*), znj.Gladiola Bregu (*mars-qershor 2022*), znj. Lumturi Zhupa (*korrik - tetor 2022*) dhe z.Orald Hoxha (*nëntor 2022- shkurt 2023*).

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 412/1 prot., datë 11.05.2024 rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë me cilësinë e lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve në trajnimin me temë “*Provueshmëria në procesin gjyqësor; arsyetimi i provueshmërisë së fakteve ligjore në proceset penale dhe civile: standardet e provueshmërisë; relevanca, besueshmëria dhe forca bindëse e provës; probabiliteti dhe provueshmëria në procesin gjyqësor; analiza e provave në arsyetimin gjyqësor dhe praktika gjyqësore*”, trajnim i zhvilluar në datën 23 nëntor 2022 (prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur më këtë tregues, përcaktohet se pikëzimi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit.

KONKLuzioni

Sa më sipër, për gjyqtarën {...} duke qenë se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë në cilësinë e lehtësueses në trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe me vendimet nr.315, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimin nr.242, datë 30.06.2022 rezulton se

gjqtarja {...} është miratuar si magjistrate gjyqtare udhëheqëse për periudhën 2021-2024, duke iu caktuar edhe gjyqtarë për mentorim për vitin 2022, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2022 nga dosja personale e gjyqtares në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e integruar gjyqtarja ka parashtruar se ka marrë pjesë në disa aktivitetet dhe konferenca shkencore të organizuara përgjatë viteve 2013- 2017, por asnjëra prej tyre nuk i përket periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-31.12.2022.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me (0) zero pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE

NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	387	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...}, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhoj kohën, duke i dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Gjyqtarja duhet të mbajnë në konsideratë pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2022-1 DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologji	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë

		për vlerësim			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarës 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarës 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësim
				94	Shkëlqyeshë
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	11-20 %	12	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë

punë		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	+99%	10	Tej standardit : Nën 81 % - 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë

		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	12	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve- 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë

					pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshë
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 p
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësim

Tregues			Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë	
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit:	

	bashkëpunimit me administratën gjyqësore	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarës	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			387		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			SHKËLQYESHËM		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR